

**BASHKIA TIRANË**  
**INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**SHPLLJE POZICIONI VAKANT**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

**Drejtor, Drejtorja Juridike (Kategoria e pagës II-b).**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

**Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor (*ose të barazvlefshme me to*), në Shkencat Juridike. Diploma e nivelit Bachelor, duhet të jetë e të njëjtës fushë, (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësimi nga MAS*);
- Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

**Drejtori Juridik ka për detyrë si më poshtë:**

Drejtori i Drejtorisë Juridike varet direkt nga Kryeinspektori.

- Drejton të gjithë veprimtarinë e drejtorisë, në realizimin e të gjithë detyrave të paracaktuara në objektivat e kësaj drejtorie ashtu dhe të gjithë urdhërat apo udhëzimet e Kryeinspektorit;
- Jep mendim juridik për të gjitha materialet, shkresat që administrata përpilon gjatë punës së saj, orienton në të gjitha aktet administrative, urdhra, udhëzime, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;
- Raporton periodikisht (raporte ditore, javore e mujore) tek Kryeinspektori për masat e marra dhe punën e kryer nga Sektori Juridik & Ankimimet;

- Siguron koordinimin dhe bashkëpunimin e veprimtarisë së punës, si brenda Drejtorisë ashtu edhe me drejtoritë e tjera në Institucion dhe me homologët e saj jashtë institucionit;
- Merr pjesë në të gjitha procedurat apo proceset, ku legjislacioni kërkon pjesëmarrjen e këtij pozicioni;
- Përgatit të gjitha materialet me karakter juridik;
- Verifikon dhe firmos të gjithë shkresat në emër të Drejtorisë Juridike;
- Analizon punën e drejtorisë dhe jep mendime për mënyrën e zgjidhjes së problematikave;
- Përgjigjet për dhënien e asistencës dhe opinionit ligjor në funksion të veprimtarisë së IMT-së;
- Angazhohet në përgatitjen e draft-akteve të ndryshme normative, rregullatorë, të marrëveshjeve apo kontratave, në ndjekjen e proceseve kontraktuale e administrative;
- Angazhohet në ndërmarrjen dhe bashkërendimin e veprimeve gjyqësore si dhe të gjitha mjeteve ligjore në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të IMT-së, duke bashkëpunuar me çdo njësi tjetër organizative të IMT-ës;
- Bën shpërndarjen e punës dhe çështjeve që i adresohen drejtorisë dhe ndjek e kontrollon punën që bëhet nga përgjegjësit e sektorëve për përcaktimin e dhënien e zgjidhjeve ligjore, në afatet e caktuara;

**Dokumentat që aplikanti për Drejtor në Drejtorinë Juridike duhet të paraqesë janë si më poshtë:**

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë ( Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Dëshmi e gjëndjes mjekësore;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Fotokopje të çertifikatave të kualifikimit;

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 30.06.2023 ora 14.00.